



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Nr. ____, Prot.

Peqin, më __/__/2025

PROJEKT-VENDIM

NR. ____, DATË __. __. 2025

Për

"MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË SI DHE MËNYRËS SË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ"

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, pika 1 dhe 2, të ligjit Nr.75/2019 "Për Rininë" neni 10, pika 3,

PROPOZOI:

1. Miratimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (referuar si KVR) dhe të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
2. KVR udhëhiqet nga parimet e gjithëpranuara të ushtrimit të detyrave në përmbushje të interesit publik dhe në veçanti nga parimi i ligjshmërisë, transparencës, mosdiskriminimit, përgjegjshmërisë dhe objektivitetit.
3. KVR përbëhet të paktën nga 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) anëtarë, ku të respektohet parimi i barazisë gjinore.
4. KVR do të ketë në përbërje:
 - a) Kryetari i Bashkisë, kryetar;
 - b) Përfaqësues i Këshillit Bashkiak ose administratës (sektori i rinisë) së njësisë administrative, anëtar;
 - c) 2 ose më shumë përfaqësues nga organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë (anëtarë);
 - d) 2 ose më shumë përfaqësues nga të rinj aktiv të Njësisë administrative (anëtarë).
5. Anëtarët e KVR emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe mandati i tyre është dyvjeçar me të drejtë riemërimi.
6. Anëtarët e KVR mund të japin dorëheqjen duke njoftuar me shkrim kryetarin. Kryetari mund të vendosë edhe për përjashtimin e ndonjë anëtari në rast të mosparaqitjes në takime për më

shumë së 2 herë rradhazi ose në raste të mospërbushjes së funksioneve. Anëtari zëvendësues plotëson mandatin e anëtarit që zëvendëson.

7. Anëtarët e KVR identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirrje për shprehje interesi për të marrë pjesë në KVR, të hartuar e të njoftuar nga Kryetari, në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose rrjetet sociale të institucionit.

8. Përzgjedhja mes individëve që kanë shprehur interes nga Këshilli Bashkiak dhe/ose nga administrata e njësisë administrative bëhet nga Kryetari duke u bazuar në kriterin e përvojës së mëparshme me organizatat jofitimprurëse dhe në projekte që lidhen me të rinjtë.

9. Përzgjedhja mes kandidatëve përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë, bëhet nga Kryetari dhe bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) Të jetë anëtar i një organizate rinore ose për të rinjtë;
- b) Të mos jetë i dënuar;
- c) Të ketë përvojë në projekte, nisma dhe veprimtari rinore dhe për të rinjtë;
- d) Të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në KVR.

10. Kandidatët për KVR, përfaqësues të organizatave rinore ose për të rinjtë duhet të aplikojnë brenda afatit dhe në adresën e përcaktuar në njoftimin përkatës duke paraqitur dokumentat e mëposhtme:

- a) Kërkesë me shkrim ku të shprehë interesin për aplikim;
- b) Jetëshkrim;
- c) Fotokopje të dokumenteve që mbështesin shënimet e jetëshkrimit;
- d) Vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
- e) Vetëdeklarim lidhur me shmangien e konfliktit të interesave;
- f) Referenca nga të paktën 2 bashkëpunëtorë të mëparshëm.

11. Kandidatët për KVR, përfaqësues nga të rinj aktiv të njësisë administrative duhet të përmbushin këto kritere:

- a) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- b) Të jetë përfshirë në organizimin dhe në zbatimin e aktiviteteve rinore apo në promovimin e të rinjve; c) Të mos ketë konflikt interesi për shkak të angazhimit në KVR.

12. Kandidatët për KVR, përfaqësues nga të rinj aktiv të njësisë administrative duhet të aplikojnë brenda afatit dhe në adresën e përcaktuar në njoftimin përkatës duke paraqitur dokumentat e mëposhtme:

- a) Kërkesë me shkrim;

- b) Jetëshkrimin (CV);
- c) Fotokopje të dokumentave që vërtetojnë jetëshkrimin;
- d) Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore ose vetëdeklarimin e saj;
- e) Letër interesi/motivimi;
- f) Vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.

13. KVR mbledhet jo më pak se 4 (katër) herë në vit. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Kryetari.

14. Veprimtaria e KVR mbështetet nga sekretari teknik që është një punonjës i bashkisë i ngarkuar nga kryetari me këtë detyrë.

15. Sekretari teknik njofton anëtarët e KVR jo më vonë se 7 ditë përpara për datën dhe orën e takimit si dhe rendin e ditës. Sekretari teknik mban minutat e takimit dhe çdo komunikim tjetër që lidhet me veprimtarinë e KVR.

16. Mbledhjet e KVR zhvillohen kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë. Nëse nuk paraqiten në mbledhje numri minimal i anëtarëve pjesëmarrës, takimi shtyhet për një datë të mëvonshme.

Konceptoi: S.Nj.I.E

Anida Sula



Nurie Luca



KRYETARI I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Peqin, më __/__/2025

RELACION

Lënda :Krijimi i Këshillit Vendor Rinor.

Një nga parimet kryesore ku mbështetet Ligji i Rinisë është parimi i garantimit të pjesëmarrjes së të rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimarrëse në fushat që janë me më shumë interes për të rinjtë. Të tilla fusha janë :arsimi,punësimi,vullnetarizmi,shëndetësia,kultura,sporti etj.

Në nenin 7,të Ligjit për Rininë përcaktohet si detyre e njësive të vetëqeverisjes vendore hartimi dhe zbatimi i politikave vendore në fushën e rinisë.Një nga përgjegjësit kryesore të këtyre politikave është krijimi i Këshillit Vendor të Rinisë.Këshilli Vendor i Rinisë duhet të influencojë në politikat vendore,të cilat ndikojnë gjërisht në pjesëmarrjen e të rinjve dhe në mbështetjen e tyre.Pjesëmarrja e organizatave rinore dhe për të rinjtë në vendimmarrje nëpërmjet platformës së Këshillit Vendor të Rinisë është premisë për adresimin e çështjeve të rëndësishme që shqetësojnë të rinjtë .

Këshilli Vendor i Rinisë është parashikuar në Nenin 10 të ligjit për rininë si një organ këshillimor që funksionon pranë kryetarit të bashkisë .Edhe kriteret apo procedura e përzgjedhjes së anëtarëve dhe mënyra e funksionimit janë të përshtatura në rang vendor dhe mundësive që ka secila bashki.

Për këtë arsye dhe miratimi i aktit përkatës për rregullimin e organizimit dhe funksionimit të KVR-VE i është lënë Këshillave Bashkiakë respektiv.

Ligji ka ofruar fleksibilitet për sa i përket numrit të anëtarëve të KVR-së.Në varësi të këtyre elementëve numri mund të jetë 4 deri në 6 anëtarë. KVR-ja kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe ka në përbërje të paktën 2 anëtarë nga organizatat rinore si dhe të rinj aktive të njesisë vendore.

Neni 5 dhe Neni 7 i ligjit për Rininë përcaktojnë marrëdhënien me qeverisjen vendore si dhe rolin e Këshillit Vendor të Rinisë.

Marrëdhëniet ndërmjet KVR-së dhe Bashkisë duhet të jenë në formën e bashkërendimit dhe bashkëpunimit në lidhje me politikat e prodhuara nga qeverisja vendore për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje.

KVR-ja shërben si ndërlidhes ndërmjet Bashkisë dhe komunitetit rinor për të evidentuar problematikat dhe sfidat që hasen nga të rinjtë në territorin ku jetojnë.

KVR-ja përmes rolit këshillues ,njeh bashkinë me nevojat ,sfidat dhe problemet me të cilat përballen të rinjtë në komunitetin lokal dhe jep rekomandime për zgjidhjen e tyre.

Bashkia planifikon politikat e saj duke marrë parasysh interesat dhe nevojat e të rinjve. Të rinjve i garantohet një platformë e strukturuar komunikimi me autoritetet lokale. Ata gjithashtu mund të konsultohen dhe mirë artikulojnë problemet që kanë para bashkisë. Këshilli Vendor i Rinisë u ofron mundësinë të rinjve të jenë pjesëmarrës në procesin e hartimit të politikave për të rinjtë dhe të kenë një kontribut të drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së tyre në mjedisin ku ata jetojnë.

1-Pjesëmarrja është një element thelbesor i qytetarisë aktive në një shoqëri demokratike.

2-Pjesëmarrja e të rinjve nuk është një qëllim më vete por një mjet për të arritur ndryshime pozitive në jetën e të rinjve dhe për të ndërtuar një shoqëri më të mirë.

3-Pjesëmarrja e të rinjve forcon zhvillimin personal dhe social, siguron ekspertizë për programet dhe shërbimet për fëmijet dhe të rinjtë dhe promovon një shoqëri demokratike.

4-Pjesëmarrja e të rinjve është një e drejtë e mbrojtur nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.

5-Pjesëmarrja e të rinjve është një proces i përfshirjes së të rinjve në insitucionet dhe vendimet që ndikojnë në jetën e tyre.

Përgatitja e projektvendimit për ngritjen e KVR-së i takon Bashkisë dhe ky projektvendim duhet të marrë miratimin e Këshillit Bashkiak.

Lançimi i thirrjes për përzgjedhjen e anëtarëve të KVR-së duke patur parasysh kriteret e miratuara në KB.

Kandidatet për KVR ,përfaqësues nga të rinj aktivë të Njësive Administrative duhet të aplikojnë brënda afatit dhe në adresën e përcaktuar në njoftimin përkatës duke paraqitur dokumentat e mëposhtme:

a-kërkesë me shkrim

b-jetëshkrimin(CV)

c-fotokopje të dokumentave që vërtetojnë jetëshkrimin;

ç-vërtetim të gjëndjes gjyqësore;

d-letër interesi;

Ky proces është transparent dhe të gjithë të rinjtë e zonave administrative duhet të njoftohen dhe të kenë mundësi të përzgjidhen.

Administrimi i aplikimeve dhe shqyrtimi i tyre bëhet nga një grup pune i brendshëm i Bashkisë i cili ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë që në fillim të këtij procesi.

Detyra e këtij grupi pune është të ndjekë të gjithë procesin duke filluar me shpalljen e thirrjes, administrimin e aplikimeve si dhe shqyrtimin e tyre deri në përzgjedhjen finale të anëtarëve fitues për në KVR të cilat ja çon Kryetarit të Bashkisë për miratim.

Vendimi i Kryetarit të Bashkisë përmban listën me emrat e të rinjve të perzgjedhur si anëtare të KVR-së dhe mandatet e tyre.

Në mbledhjen e parë të KVR-së do të formalizohet struktura e Këshillit.

Mbledhjet do të drejtohen nga Kryetari i Bashkisë i cili në të njëjtën kohë është dhe kryetari i KVR-së.

Po në mbledhjen e parë përcaktohet edhe sekretari i këshillit i cili zgjidhet nga të rinjtë e KVR-së.

Sekretari ka rol kyç në KVR pasi mban protokollin e mbledhjeve, kordinon dhe njofton anëtarët e KVR-së për të gjitha aktivitetet dhe mbledhjet që do kenë.

Në mbledhjen e parë miratohet dhe rregullorja e KVR-së.

Anëtarët e Këshillit Vendor të Rinisë monitorojnë dhe sugjerojnë nisma dhe aktivitete të përbashkëta për çeshtjet e rinisë me bashkinë.

Konceptoi:

Spec.Nj.I.E

Anida Sula


Spec.Nj.I.E

Nurka Lluca



MIRATOI:

Julian Manahasa